



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 186, Datë 25.11.2019

MBI

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E DRAFT – “METODOLOGJISË SË PËRCAKTIMIT TË TARIFËS TË SHITJES SË GAZIT NATYROR NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT”.

Në mbështetje të nenit 90, pika 11, të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” i ndryshuar, të nenit 19 dhe 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s” miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 25.11.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 111/6 Prot, datë 22.11.2019, të Drejtorisë së Tarifave dhe Çmimeve, mbi miratimin e Draft- “Metodologjisë të përcaktimit të çmimit të shitjes të gazit natyror nga furnizuesi i mundësisë së fundit”,

Konstatoi se:

- Në mbështetje të nenit 90, pika 11, të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar, ERE miraton metodologjinë për përcaktimin e tarifës së shitjes së gazit natyror nga furnizuesi i mundësisë së fundit.
- Kjo metodologji shërben për përcaktimin e tarifës së shitjes së gazit natyror të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, bazuar në parime të qarta të tarifimit dhe detajimin e të dhënave të nevojshme për përcaktimin e tarifave sa më të drejta dhe transparente në këtë fushë të rëndësishme.
- Kjo metodologji do të gjejë zbatim vetëm mbi të licencuarin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit në sektorin e gazit natyror, i caktuar në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurës për shqyrtimin e Draft – “Metodologjisë së përcaktimit të tarifës së shitjes së gazit natyror nga furnizuesi i mundësisë së fundit”.
2. Drejtoria e çështjeve ligjore, të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI